R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë

MINISTRIA E MBROJTJES

INSTITUTI I GJEOGRAFISË DHE INFRASTRUKTURËS USHTARAKE

# PLANI I INTEGRITETIT

- *Përmbajtja*


- Përmbledhje Ekzekutive
- Objektivi 1: Rritja e transparencës dhe llogaridhënies
- Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit arkivor
- Objektivi 3: Forcim i mekanizmave të kontrollit të brendshëm
- Konkluzione dhe Rekomandime

**Përmbledhje Ekzekutive**

*PLANI I INTEGRITETIT*

Ndërtimi i integritetit do te mbetet përherë një aspekt kyç i mirëfunksionimit të demokracisë e padyshim shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës.

Duke pasur në fokus luftën kundër korrupsionit në institucion dhe për rrjedhojë për të parandaluar rreziqet e mundshme , në kuadër të planit të integritetit, IGJIU si strukturë varëse e Ministrisë së Mbrojtjes, ka marrë në analizë, pasi ka identifikuar fushat përkatëse ,dy të tilla:

1. Fusha e menaxhimit arkivor

2.Fushën e menaxhimit financiar dhe kontrolli i brendshëm

Nëse i referohemi fushës së parë të marrë në analizë evidentojmë riskun që lidhet me menaxhimin e dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve dhe administrimi i aktiveve.

Duke pasur në konsideratë që menaxhimi arkivor përbën një prej elementëve kyç në sistemin që ofrohet online, nëpërmjet sistemit SQDNE, menaxhimi efektiv i tyre dikton marrjen e masave për të shmangur problematika ndaj dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve dhe administrimi i aktiveve si dhe mbi të gjitha zgjidhjen drejt përmirësimit e konsolidimit të sistemit.

| ***Objektivi 1*** | *Masa dhe Aktivitete* | *Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve* | |
|---|---|---|---|
| Menaxhimin e dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve dhe administrimi i aktiveve | Dhënie së shërbimit ndaj qytetarëve dhe administrimi i aktiveve | Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024 | Aktivitete në proces realizimi për vitin 2024 |
| | | **38** | **0** |

Për rrjedhojë është shumë e rëndësishme dixhitalizimi dhe automatizimi i proceseve te shërbimeve qe jep IGJIU duke patur parasysh që informacioni që ato përmbajnë është tejet sensitiv.

**Commented [SSKSM1]:** Referojuni planit te integritetit per unifikim. Me poshte citohet si fusha e menaxhimit financiar dhe prokurimeve.

**Commented [SSKSM2]:** Nevojitet nje paragraph ku te me citoni sa masa keni parashikuar, sa aktivitete, dhe realizimi I tyre.

**Commented [SSKSM3]:**

Për sa më sipër, në zbatim të VKM nr.252, date 29.04.2022, "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre", Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr.1129, datë 25.07.2022 "Për miratimin e rregullores "Mbi mënyrën e zbatimit të detyrave për procedurat e ofrimit te shërbimeve online", Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake ofron shtatë shërbime online, konkretisht:

Aplikim për Harta Topografike të Përpiluara dhe Botuara nga IGJIU ndër vite

- Aplikim për kopje të hartave të vjetra me rëndësi historike Kombëtare
- Aplikim për Fotografim Ajror
- Aplikim për Harta Detare
- Aplikim për Harta Topografike Ruse
- Aplikim për Harta Tematike
- Aplikim për Pika të Triangulacionit dhe Nivelacionit Shtetëror Kl I; II;III

Nevoja për Implementimin e hartave në sistemin e-Albania.

Në spektrin e fushës financiare, për prioritetet e 2024 diktohet nevoja për caktimin e një koordinatori risku i cili do të trajnohet për këtë qëllim.

Nga ana tjetër për realizimin sipas standardeve ligjore të procedurave për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve vepruese në çështjet e prokurimit vlen të theksojmë domosdoshmërinë që anëtarët e komisionit të bëjnë persona jo të lidhur, pra në mungesë të çdo lloj konflikti interesi qoftë me operatorët konkurrues edhe me operatorin e përzgjedhur si fitues. Niveli i lartë i transparencës duhet të udhëheqë të gjithë këtë proces. Për rrjedhojë është e nevojshme që në mënyrë të vazhdueshme anëtarët e komisioneve respektive të trajnohen vazhdimisht.

Vënia në zbatim e planit të integritetit do të jetë një shtysë për zhvillimin e mëtejshëm të strukturave shtetërore, për të forcuar shtetin e së drejtës.

| **RISKU** | **MASA QË DO TË MERRET** | **NJËSIA PËRGJEGJËSE** | **AFATI** | **AKTIVITETET** | **BURIMET** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. **Menaxhimi arkivor** . | Implementimi i hartave në sistemin e-Albania | Sektori MIA<br>Sektori Mbështetjes | Dhjetor 2024 | Përmirësim në mënyrën sesi shërbimi ofrohet online | IGJIU |

1. **Fusha e menaxhimit financiar dhe kontrolli i brendshëm.**

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është:
*“Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik”*
“Likuidimi në kohë nga ana e institucionit dhe subjekteve ndaj IGJIU-se”
“Grumbulli i te ardhura nga shitjet e hartave”
“*Menaxhimi i efektshëm i fondeve buxhetore të IGJIU-së*”

**Commented [SSKSM4]:** Referojuni planit te integritetit per unifikim. Me poshte citohet si fusha e menaxhimit financiar dhe prokurimeve.

**Commented [SSKSM5]:** Citojeni sipas planit pasi ketu e keni fusha e menaxhimit financiar dhe prokurimeve publike, ndersa me siper e keni fusha e menaxhimit financiar dhe kontrolli I brendshem.

| ***Objektivi 1*** | *Masa dhe Aktivitete* | *Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve* | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Aktivitete të parashikuara për 6 mujorin e vitin 2024 | Aktivitete të realizuara për vitin 2024 | Aktivitete në proces realizimi për vitin 20 |
| Procedurat elektronike të prokurimit të fondeve buxhetore | Procedurat elektronike të prokurimit të fondeve buxhetore , pergatitja e dokumentacionit sipas akteve ligjore | **6** | **5** | **1** |

**Commented [SSKSM6]:** Ne lidhje me kete tabele duhet edhe ne menyre narrative e shpjeguar. Per vitin 2024 keni te parashikuara 17 aktivitete ne process realizimi. Per keto 17 aktivitete duhet te sqarohen sa jane realizuar plotesisht, sa jane ne process dhe sa jane pa realizuar fare. Per cdo aktivitet te realizuar lutemi evidence si linqe apo urdhra udhezime ca mund te jene miratuar, apo te cfaredolloj natyre.

Regjistri i parashikimeve te prokurimeve per vitin 2024 Link:https://eprocurement.app.gov.al/#MY_Workplace/Procurement_Plan_WF

Regjistri i realizimeve te prokurimeve per vitin 2024 Link: https://eprocurement.app.gov.al/#MY_Workplace/Procurement_Plan_Realization



| ***Objektivi 2*** | *Masa dhe Aktivitete* | *Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve* | | |
|---|---|---|---|---|
| Likuidimi në kohë nga ana e institucionit dhe subjekteve ndaj IGJIU-se | Likujdimi ne kohe i detyrimeve ndaj te treteve (mos krijim i detyrimeve te prapambetura), plotesim I dokumentacionit te nevojshem per likujdim. | Aktivitete të parashikuara për vitin 2024 | Aktivitete të realizuara për vitin 2024 | Aktivitete në proces realizimi për vitin 2024 |
| | | **6** | **0** | **5** |




| ***Objektivi 3*** | *Masa dhe Aktivitete* | *Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve* | | |
|---|---|---|---|---|
| Grumbulli i te ardhura nga shitjet e hartave, | Dhënia e shërbimit qytetarëve, si dhe shitja e hartave elektronike | Aktivitete të parashikuara për vitin 2024 | Aktivitete të realizuara për vitin 2024 | Aktivitete në proces realizimi për vitin 2024 (te ardhura te konstatuara) |
| | | **4,500,000 leke** | **1,659,026 leke** | **1,477,180 Leke** |




| ***Objektivi 4*** | *Masa dhe Aktivitete* | *Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve* | | |
|---|---|---|---|---|
| *Menaxhimi i efektshëm i fondeve buxhetore të IGJIU-së"* | *Menaxhimi i efektshëm i fondeve buxhetore të IGJIU-së"*, kryerja e pagesa ndaj punonjesve te IGJIU-se dhe ndaj te treteve ne % | Aktivitete të parashikuara për vitin 2024 | Aktivitete  të realizuara për vitin 2024 | Aktivitete në proces realizimi për vitin 2024 |
| | | **100%** | **30%** | **22%** |



Realizimi i objektivave të përcaktuara në planin e integritetit ka qene një ndër elementët risi për strukturën e IGJIU-së, parë kjo edhe në faktin se në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe eficencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Pasi jemi njohur në tërësi me elementët e integritetit dhe kemi përcaktuar fushat ku përfshihemi, faza tjetër me rëndësi ka qenë pikërisht realizimi i synimeve të përcaktuara dhe monitorimi për zbatimin e tyre.

Struktura e IGJIU-së, ka parë si të nevojshme pjesëmarrjen e personelit në trajnime lidhur me funksionimin e politikave të privatësisë, politikat e antikorrupsionit dhe mirëfunksionimit të administratës publike, si një element thelbësor në procesin e rritjes dhe forcimit të kapaciteteve dhe transparencës me qëllim mirë menaxhimin e burimeve njerëzore.

Për rrjedhojë gjatë 6 mujorit të parë të monitorimit, një pjesë e personelit ka arritur të aksesojë në trajnimet e realizuara qofshin këto online apo në auditorë.

**Commented [SSKSM7]:** Duhet nje evidence e natyres cfare trajnimesh jane realizuar, kush nga sektoret ka marre pojese, kush I organizon trajnimet dhe ne cfare fushash, vendosni titujt e trajnimeve.

Përmes të qënurit prezent dhe ndjekjes së tyre është vënë re një përmirësim i ndjeshëm lidhur me realizimin edhe të detyrave funksionale dhe të paturit informacion lidhur me ndryshimet më të fundit sa i takon sektorit publik, të ofruara nga ASPA.

| | *Masa dhe Aktivitete* | *Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve* | |
|---|---|---|---|
| ***Trajnimet e personelit nga ASPA*** | 1. Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi I proçedurave administrative. (2 punonjes)<br>2. Organizimi i ri Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore dhe roli i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (1 punonjes)<br>3. Rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rinjve përmes edukimit cilësor (1 punonjes)<br>4. Mbrojtja, mbështetja dhe siguria e të rinjve (1 punonjes).<br>5. Organizimi i ri Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore dhe roli i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. (1 punonjes). | Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024 | Aktivitete në proces realizimi për vitin 2024 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 6. Performanca e njësisë të vetëqeverisjes vendore (1 punonjes)<br>7. Formulimi i projekteve (2 punonjes)<br>8. Konsiderata të përgjithshme për menaxhimin e zbatimit të projekteve (2 punonjes).<br>9. Menaxhimi i palëve të interesuara në zbatimin e projekteve (2 punonjes).<br>10. Sulmet Phishing, metodat e reja të sofistikuara (1 punonjes).<br>11. Përdorimi i mediave sociale në Administratën Publike 2, (1 punonjes).<br>12. Përdorimi i mediave në administratën publike 3 (1 punonjes).<br>13. Zbatimi dhe monitorimi i politikave publike,(2 punonjes).<br>14. Qeverisja dhe standardet e sigurisë kibernetike.(1 punonjes).<br>15. Siguria kibernetike dhe Qeverisja elektronike. (1 punonjes).<br>16. Menaxhimi i riskut.( 3 punonjes).<br>17. Vleresimi dhe menaxhimi i projekteve te zhvillimit. (2 punonjes)<br>18. Transparenca Proaktive e autoriteteve publike,(1 punonjes).<br>19. Rritja e kapaciteteve njerezore ne drejtim te rritjes se performances ne pune. ( 2 punonjes).<br>20. Kodi i punes dhe zbatimi i tij në një marrëdhënie pune.(3 punonjes).<br>21. Eksperitiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve dhe proçedura e asgjësimit të tyre. (1 punonjes). | **20** | **1** |

Megjithatë, një pjesë e personelit nuk ka mundur dot të ketë akses në platformën që përfshinte trajnimet referuar administratës publike, përdorimit dhe ndikimit të medias në administratë, si dhe njohuritë mbi metodat e reja të sofistikuara.

Ndërkohë një tjetër fushë me rëndësi paraqitet ajo financiare dhe e prokurimeve publike, sidomos sa i takon nevojës për një proces transparent në të gjithë hallkat e tij, parë kjo në kuadër të shtetit të së drejtës.

Nga ky objektiv i përcaktuar, pritet të zhvillohen në vijim trajnime lidhur me menaxhimin e riskut, për shkak se në bazë të raportimit të bërë numri i kuotave në fazën e parë përzgjedhëse ka qenë i plotësuar. Trajnimet kryesisht jane të ofruara nga ASPA, sipas specifikes se vecante qe IGJIU ka ne prefesione jane kryer trajnime me kompani private (perdorim instrumenta gjeodezik, perdorim te progrogrameve fotogrametrike, hartografike, etj,).

Commented [SSKSM8]: Kush do ta zhvillopje trjanimin? Keni bere kerkese? Ne rast se po lutemi referojuni.

Ne cdo fillim vit planizohen trajnime, aktivitete.

Vlen të theksojmë se në kuadër të kontrollit të brendshëm një tjetër objektiv i parashikuar është ai që lidhet me koordinatorin e riskut dhe politikat efikase për një administratë demokratike.

Commented [SSKSM9]: E keni te parashikuar ne planin e masave kete objektiv? E keni te caktuar koordinatorin e riskut?

Ne IGJIU nuk kemi kordinator te riskut, rregjistrin e riskut e kryen financa

Të tilla objektiva të përcaktuara do të vazhdojnë të jenë nën monitorim përgjatë 6 mujorit tjetër të planit të integritetit, me qëllim realizimin e tyre 100%.

**<u>Konkluzione dhe Rekomandime</u>**

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit të dërguar nga Ministria e Mbrojtjes.

Përgjatë vitit 2024 IGJIU, si strukturë varësie e Ministrisë së Mbrojtjes ka realizuar një pjesë të objektivave të parashikuara nga Plani i Integritetit përgjatë vitit, për të vijuar me realizimin final të tyre gjatë dy viteve pasardhëse: 2025 dhe 2026, duke përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë dokument.

Commented [SSKSM10]: Per kete duhet nje grafik I realizimit te pergjithshem.

**Hapa të tjera**

- Të vijohet me realizimin e objektivave të parashikuar në Planin e Integritetit.
- Të vijohet me realizimin e monitorimit me qëllim zbatimin final të planit të parashikuar në të gjitha objektivat e tij.

Te caktohet koordinator risku

Të raportohet lidhur me ecurinë e monitorimit në strukturën përgjegjëse, Ministria e Mbrojtjes.

Commented [SSKSM11]: Nese nuk e keni te caktuar koordinatorin e riskut vendoseni si hap me vete